



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni Pranveror
Kryesia e Kuvendit
P-059

Prishtinë, më 3 mars 2023, ora 11:25
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 MARS 2023

Në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Mungoi: Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Mërgim Lushtaku, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Përgatitjet për seancën plenare të re,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 20 shkurt 2023

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 20 shkurt 2023.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme

Pas diskutimeve, kryetari me konsensus vendosi që vazhdimi i nëntë (9) seancave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbahet të mërkurën, më 8 mars 2023, në orën 12:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 23 dhjetor 2022 dhe 22 shkurt e 2 mars 2023:

5. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-162 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për “Projektin e reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë”,
6. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-203 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për Projektin -korniza e qyteteve të gjelbra 2 dritarja 2 - eficiency e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
7. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-204 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për Projektin - eficiency e energjisë në ndërtesa publike në Prizren, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-152 për antidopingun,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-072 për bujqësi dhe zhvillim rural,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-190 për Zhvillimin Rajonal të Balancuar,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore,
14. Debat parlamentar në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022,
15. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2021.

II. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 22 dhjetor 2022:

1. Votimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031.

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 9 dhjetor 2022 dhe 8 shkurt 2023:

10. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative,
11. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-192 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit,
12. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-182 për konfliktet administrative,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-191 për ekspertët gjyqësor,

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-194 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugor,
16. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për gjendjen në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,
17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2021,
18. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2021,
19. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për vitin 2021,
20. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2021,
21. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2021,
22. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Statistikave të Kosovës për vitin 2021,
23. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike,
24. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë,
25. Shqyrtimi i Planit Kombëtar të Radio-frekuencave,
26. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar,
27. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave,
28. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa të Mediave,
29. Zgjedhja e një (1) zëvendësi të Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

IV. Seanca plenare e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 12 dhjetor 2022:

1. Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në lidhje me çështjen: “Siguria juridike e grave në rastet e dhunës në familje dhe përgjegjësia e organeve shtetërore në parandalimin edhe luftimin e krimeve ndaj grave dhe vajzave”.

V. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 19 janar 2023:

5. Votimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2021,
7. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike.

VI. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 2 shkurt 2023:

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-200 për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse,
19. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2021,
20. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2021,
21. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2021,
22. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2021,
23. Shqyrtimi i Rekomandimeve lidhur me Raportin e auditimit të performansës “Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare,
24. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb.

VII. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 9 shkurt 2023:

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-199 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore,
16. Shqyrtimi i rekomandimeve për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike,
17. Përzgjedhja e një (1) anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK).

VIII. Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 13 shkurt 2023:

1. Debat parlamentar për zhvillimet në dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

IX. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 23 shkurt 2023:

8. Votimi i Raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-208 për parqet industriale dhe teknologjike,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-209 për investime të qëndrueshme,
11. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për miratimin e rekomandimit të Komisionit Ndërmnistror për Investime Strategjike për dhënien e statusit Investitor Strategjik për subjektin investues “Moxico Luma Kosova Mining L.L.C.”,
12. Shqyrtimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
13. Propozimi i GP Multietnik për shkarkimin e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bekim Arifi.

3. Përgatitjet për seancën plenare të re

Kryetari, pas diskutimeve për rendin e ditës të propozuar për seancë plenare, me miratimin e tij me konsensus, vendosi që seanca e re plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 9 mars 2023, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
2. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
3. *Pyetjet parlamentare,*
4. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-137 për pyjet,*
5. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-172 për sigurinë e përgjithshme të produkteve,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-158,*
8. *Shqyrtimi i Raportit të performansës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2021,*
9. *Shqyrtimi i Rekomandimeve lidhur me Raportin e auditimit “Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra”,*
10. *Shqyrtimi i Rekomandimeve lidhur me Raportin e auditimit “Performansa financiare dhe operative NP “Trepça sh. a.”,*
11. *Emërimi i drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*
12. *Shqyrtimi i Projekt-Deklaratës në mbështetje të Fondit Kosovaro-Amerikan për Arsim (KAEF).*

* * *

Po ashtu, me propozim të kryetarit dhe me miratim me konsensus, u vendos që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të hënën, më 6 mars 2023, në orën 12:00, të mbajë seancë solemne, me këtë:

Rend dite

1. Shënimi i 25-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në lidhje me këtë seancë solemne u vendos që, pos të ftuarve tjerë, të ftohen edhe familjet e dëshmorëve nga radhët e komuniteteve, ndërsa folës do të jenë sikur ishin në seancën solemne për shënimin e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për strukturën organizative, klasifikimin e pozitive, shtesat dhe kompensimet mbi pagën bazë të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia e Kuvendit e shtyri përsëri miratimin e Projekt-Rregullores për strukturën organizative, klasifikimin e pozitive, shtesat dhe kompensimet mbi pagën bazë të nëpunësve civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Shqyrtimi i mocionit të shtatë (7) deputetëve nga GP i AAK-së: Projekt-rezolutë për dyvjeçarin e Qeverisë Kurti II

Kryetari i Kuvendit, me propozim të kryetarit të GP të AAK-së, Besnik Tahiri, dhe me konsensusin e të pranishmëve, shqyrtimin e Projekt-rezolutës për dyvjeçarin e Qeverisë Kurti II e radhiti në rendin e ditës së seancës plenare të radhës, e cila do të mbahet më 23 mars 2023.

3. Shqyrtimi i mocionit të shtatë (7) deputetëve: Projekt-Deklaratë në mbështetje të Fondit Kosovaro-Amerikan për Arsim (KAEF)

Kryetari e radhiti me konsensus shqyrtimin e Projekt-Deklaratës në mbështetje të Fondit Kosovaro-Amerikan për Arsim (KAEF) në rendin e ditës së seancës plenare, e cila do të mbahet më 9 mars 2023.

4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2022

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2022.
2. Autorizohet Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta publikojë Raportin nga pika një (1) e këtij vendimi.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Uashington D.C. (ShBA)

Kryesia e shtyu shqyrtimin e kërkesës së deputetes Yllza Hoti për lejimin e udhëtimit zyrtar në Uashington D.C. (ShBA), prej datës 8 deri më 12 prill 2023.

6. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë)

Në lidhje me kërkesën për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë) të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentare për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë diskutoi kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Mimoza Kusari-Lila, Elmi Reçica, Armend Muja, Dimal Basha, Jeta Statovci, Fitore Pacolli-Dalipi, Floretë Zejnullahu, Rrezarta Krasniqi, Pal Lekaj dhe Bahrim Shabani u lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë), prej datës 14 deri më 17 mars 2023.
2. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ariana Musliu-Shoshi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë), prej datës 15 deri më 16 mars 2023.
3. Këshilltarit të jashtëm të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Besnik Vasolli, i lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë), prej datës 14 deri më 17 mars 2023.
4. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit (me tejkalim të shpenzimeve) dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikat një (1), dy (2) dhe tre (3) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Tiranë (Shqipëri)

Kryesia, në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Jeta Statovci dhe Fitore Pacolli-Dalipi, u lejohet udhëtimi zyrtar në Tiranë (Shqipëri), prej datës 3 deri më 5 mars 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të lartshënuarat në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

8. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të drekës së shtruar për Presidentin e Republikës së Shqipërisë

Kryesia, në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 1 596,10 euro për drekën e shtruar nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Sh. T. Bajram Begaj, më 17. 2. 2023, sipas faturës së bashkëngjitur.

9. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të drekës më 24 shkurt 2023

Kryesia, në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 1 193,20 euro për drekën e shtruar nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për gazetarët ukrainas të strehuar në Kosovë, më 24. 2. 2023, sipas faturës së bashkëngjitur.

* * *

Pikat shtesë:

1. Inicimi i procedurës për formën e logos së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se sipas nenit 6, paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit e miraton formën e logos së Kuvendit, e cila vendoset në hapësirat e Kuvendit, në zyrat e deputetëve, në dokumente e akte të brendshme, në komunikimet e deputetit me palët e treta, në botime e publikime ose në aktivitete, të cilat organizohen nga Kuvendi.

Ai po ashtu theksoi se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3 tetor 2022, ka diskutuar në lidhje me formën e logos së Kuvendit dhe ka kërkuar nga Administrata e Kuvendit që ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit për veprimet që duhet të ndërmerren për iniciimin e procedurës për shpalljen publike.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Më pas, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i njoftoi të pranishmit se ka filluar me iniciativën për fillimin e veprimeve për logon e Kuvendit, duke kontaktuar me Fakultetin e Arteve për një mundësi të lidhjes së memorandumit të bashkëpunimit për një apo dy propozime për ide për logo nga ky fakultet, ndërsa pasi të vendosë Kryesia e Kuvendit për procedurën, atëherë ai do ta mbajë të informuar Kryesinë e Kuvendit.

Diskutimi i plotë i Sekretarit të Kuvendit është dhënë në transkript.

Më pas, në lidhje me procedurën për formën e logos së Kuvendit, diskutuan: kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca; nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci; kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri; sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, dhe kryetari i GP Multietnik, Enis Kervan, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia mori këtë:

V E N D I M

1. Të fillohet procedura për formën e logos së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që t'i ndërmarrë veprimet në lidhje me zhvillimin e procedurave për formën e logos së Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit për hapat që duhet ndërmarrë në lidhje me këtë çështje.

2. Vendimi i Kryesisë së Kuvendit për lejimin e udhëtimeve zyrtare të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës për vitin 2023

Nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, njëherësh kryesuese e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, propozoi që vendimit të Kryesisë së Kuvendit për lejimin e udhëtimeve zyrtare të këtij delegacioni për vitin 2023 t'i shtohet një dokument për mundësitë e mosrealizimit të të gjitha udhëtimeve të parapara, në rastet kur ato nuk janë të nevojshme, sipas vlerësimit nga anëtarët e këtij Delegacioni për rëndësinë e pjesëmarrjes nëpër aktivitetet e organizuara nga kjo Asamble Parlamentare. Diskutimi i plotë i nënkryetares, znj. Bogujevci, është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia, në lidhje me udhëtimet zyrtare për vitin 2023 të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, vendosi:

I.

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci dhe Besnik Tahiri, u lejohet udhëtimi zyrtar në Nju-Jork (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), nga data 4 deri më 7 mars 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit (me tejkalim të shpenzimeve) dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

II.

P Ë R F U N D I M

Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, udhëtimet zyrtare për vitin 2023 të lejuara nga Kryesia e Kuvendit më 6. 2. 2023, mund t'i realizojë sipas vlerësimit të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjes nëpër aktivitetet e organizuara nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Tajvan

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Blerta Deliu-Kodra, Driton Selmanaj, Fridon Lala, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Armend Zemaj dhe Bekë Berisha u lejohet udhëtimi zyrtar në Tajvan, nga data 10 deri më 17 mars 2023.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Kërkesa e Grupit joformal të Grave Deputete për një dhomë për gjidhënie brenda Kuvendit

Kryesia, në lidhje me kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

1. Në objektin e Kuvendi të Republikës së Kosovës lejohet një hapësirë (dhomë) për shfrytëzim nga gratë gjidhënëse.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bashkëpunim me Grupin joformal të Grave Deputete, ta caktojë një hapësirë (dhomë) nga pika një (1) e këtij vendimi, si dhe ta përshtatin dhomën në fjalë me të gjitha kushtet e nevojshme për gratë gjidhënëse.

Të ndryshme:

Kryetari i Kuvendit propozoi që nënkryetarëve të Kuvendit t'u shtohet edhe nga një (1) këshilltar.

Plotësimi i pozitave edhe me nga një (1) këshilltar mund të përfshihet në Rregulloren e brendshme të Kuvendit që kanë të bëjnë me stafin politik, e cila pritet të procedohet nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 12:16 minuta.

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale